



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE TREGETISE DHE ENER GjITIKES
DREJTORIA E SHERBIMEVE JURIDIKE

URDHER

Nr. 196, date 9.03.2009

“PER MIRATIMIN E TIPIT TE INSTRUMENTEVE MATESE LIGJERISHT TE KONTROLLUARA”

Ne zbatim te nenit 22, pika 4, te Ligjit Nr.9875, date 14.02.2008 “Per metrologjine” , me propozim te Drejtorise te Pergjithshme te Metrologjise, Ministri i Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes:

URDHERON:

1. Cdo instrument mates ligjerisht i kontrolluar qe prodhohet apo hyn ne Republiken e Shqiperise duhet te miratohet (ose njihet) nga DPM. Miratimi i tipit te instrumentave matese ligjerisht te kontrolluara do te jepet nga Drejtori i Drejtorise te Pergjithshme te Metrologjise ne perputhje me proceduren e paraqitur ne kete rregullore bashkengjitur ketij urdheri dhe ne baze te kerkesave te paraqitura ne Rregulloren e Keshillit te Ministrave ” Per kerkesat teknike dhe metrologjike per instrumentat matese ligjerisht te kontrolluara” te miratuar me VKM 1351,date 03.10.2008.
2. Ky urdher eshte i vlefshem deri ne momentin qe Shqiperia behet anetare me te drejta te plota e Bashkimit European
- 3..Ky urdher hyn ne fuqi menjehere

MINISTRI

GENC RULI

RREGULLORE

” PER PROCEDUREN E MIRATIMIT TE TIPIT TE INSTRUMENTEVE MATESE LIGJERISHT TE KONTROLLUARA ”

Masat e pergjithshme

Neni 1

Miratimi ose njohja e tipit te instrumenteve mates behet per te vertetuar qe projekti (modeli) i nje instrumenti te ri eshte i pershtatshem per perdorim dhe i lejon ata per te bere verifikimin fillestar te tyre. Per te realizuar miratimin ose njohjen e tipit, DPM pergatit procedurat perkatese sipas kerkesave metrologjike. DPM aplikon proceduren e verifikimit fillestar te instrumentve matese ligjerisht te kontrolluar, dhe kur kjo e fundit nuk kerkohet sipas Rregullores se Keshillit te Ministrave «Per kerkesat teknike dhe metrologjike te instrumenteve matese ligjerisht te kontrolluara» te miratuar me VKM Nr.1351,date 03.10.2008 (ketej e tutje Rregullorja e Keshillit te Ministrave), dhe leshon Certifikaten perkatese per ti hedhur ato ne treg apo per ti vene ne perdorim

Neni 2

Ne se Rregullorja e Keshillit te Ministrave aplikohet per ate kategori instrumentesh matese qe perjashtohen nga miratimi i tipit, instrumentet matese qe perfshihen ne kete kategori do ti nenshtrohen procedures se verifikimit fillestar

Neni 3

Drejtori i Drejtorise te Pergjithshme te Metrologjise jep miratimin e tipit dhe leshon certifikaten e miratimit te tipit per secilin instrument qe kenaq kerkesat e dhena ne kete procedure dhe ne Rregulloren e Keshillit te Ministrave lidhur me instrumentin ne fjale. Ne vend te caktuar te modelit ngjitet shenja perkatese qe tregon miratimin.

Neni 4

Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise mban nje regjister te te gjitha tipeve te instrumenteve matese te miratuar apo te njohur dhe informon rreth tipeve te miratuara ne Buletinin Zyrtar ose me kerkese.

Kerkesa per miratim tipi te instrumentave matese

Neni 5

Kerkesa per miratim tipi mund te behet vetem nga prodhuesi ose perfaqsesi i tij i vendosur ne Shqiperi.

Neni 6

Kerkuesi duhet te dorezoje ne Drejtorine e Pergjithshme te Metrologjise nje kerkese sipas Aneksit 1, te perfshire ne kete urdher

Neni 7

Kerkesa dhe korespondenca qe lidhet me te duhet te jete ne gjuhen shqipe. Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise ka te drejte te kerkoje dokumente te tjera shtese qe gjithashtu duhet te jene ne shqip.

Neni 8

Kerkesa duhet te shoqerohet nga dokumente te nevojshme per vleresim e instrumentit mates, ne dy kopje ne origjinal dhe ne veçanti:

1. Nje pershkrim te veçante te:
 - a. Ndertimin dhe funksionimin e instrumentit
 - b. Rregullat mbrojtese qe sigurojne nje pune korrekte
 - c. Paisjet per rregullim dhe (pershtatje) axhustim
 - d. Vendet e synuara per vendosjen e:
 - i. Shenjes se miratimit/ verifikimit
 - ii. Vulat (ne se aplikohen)
2. Vizatimet e pergjithshme dhe kur nevojiten vizatime te detajuara te perberesve te rendesishem
3. Nje vizatim skematik qe ilustron parimet e funksionimit dhe kur eshte e domosdoshme dhe fotografi
4. Nje moster apo maket te instrumentit

Neni 9

Kerkesa do te shoqerohet, kur duhet, nga dokumente te rendesishme per miratime kombetare tashme te dhena .

Ekzaminimi per miratim tipi te instrumenteve matese

Neni 10

Ekzaminimi duhet te perfshije:

1. Studim te dokumenteve dhe nje ekzaminim te karakteristikave te matjeve te tipit ne labororet e Drejtorise te Pergjithshme te Metrologjise, ne laborore te akredituara per testim qe lidhen me kategorine perkatese te instrumenteve matese ose ne vendin e prodhimit, te shperndarjes ose te instalimit
2. Ne se karakteristika e matjeve te tipit njihen ne detaje, behet vetem nje ekzaminim te dokumenteve te dorezuara

Neni 11

Ekzaminimi do te perfshije te gjithe performancen e instrumentit mates ne kushte normale te perdorimit. Ne kushte te tilla, ky instrument duhet te ruaje karakteristikat e kerkuara te matjeve

Neni 12

Natyra dhe fusha e aplikimit të ekzaminimit të përmenduar në nenin 11 mund të specifikohet nga Rregullorja e Keshillit të Ministrave

Neni 13

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë mund të kërkojë që aplikanti të verë në dispozicion të saj etalone dhe mjete të përshtatshme në materiale dhe personel ndihmes për kryerjen e testit të miratimit

Shqyrtim i dokumentacionit teknik të instrumenteve matëse

Neni 14

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë do të studiojë aplikimin dhe dokumentet brenda një periudhe një mujore dhe do të informojë aplikantin rreth:

1. Laboratoreve që do të kryejnë testimin e tipit dhe ekzaminimin ose
2. Vendin e testimit të tipit dhe ekzaminimit

Testimi i tipit të instrumenteve matëse

Neni 15

Kerkuesi do të dorëzojë tek laboratorët e përmenduar në nenin 14 një numur të përshtatshëm të mostrave të tipit të instrumenteve matëse si përcaktohet në Rregulloren e Keshillit të Ministrave shoqëruar nga dokumentacione teknike si dhe mbulon shpenzimet e testimit të tipit dhe ekzaminimit.

Neni 16

Kerkuesi do të sigurojë kushte normale pune në vendin e instalimit apo përdorimit si dhe tek instrumentet matëse, të verë në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë mjete dhe personelin e nevojshëm dhe të mbulojë shpenzimet që lidhen me testimin e tipit dhe ekzaminimin.

Vlerësimi i tipit të instrumentit matës

Neni 17

Bazuar në raportet e testimit, Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit do të vlerësojë përputhshmerinë e tipit me Rregulloren e Keshillit të Ministrave dhe masat e këtij urdheri, të aplikueshme në një kategori instrumentesh matëse dhe do të nxjerrë konkluzionin rreth konformitetit të tipit brenda dy javësh pas përfundimit të raportit të fundit të testimit

Leshimi i çertifikatës të miratimit të tipit dhe vlefshmeria e saj

Neni 18

Kur Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise ka perfunduar ekzaminimin e tipit te nje instrument mates dhe eshte nxjerre nje konkluzion pozitiv per perputhshmerine, Drejtori i Drejtorise te Pergjithshme te Metrologjise do te jape miratimin e tipit, dhe leshoje certifikaten e miratimit te tipit (Aneksi 2) perfshire ne kete urdher dhe ja dergon ate kerkuesit

Neni 19

Çertifikata do te jape rezultatet e ekzaminimit te tipit dhe do te specifikojë kërkesat e tjera që duhet të përmbushen, e të shoqërohet me përshkrime, vizatime dhe diagrama të domosdoshme për të identifikuar tipin dhe shpjeguar funksionimin e tij.

Neni 20

Miratimi i tipit të Drejtorisë të Përgjithshme të Metrologjisë do të jetë i vlefshëm për një periudhë 10 vjet. Ajo mund të zgjatet dhe për një periudhë pasardhëse prej 10 vjet të tjera. Numeri i instrumenteve matese që mund të prodhohen në përputhje me tipin e miratuar do të jetë i pakufizuar .

Neni 21

Miratimi i tipit të Drejtorisë të Përgjithshme të Metrologjisë i dhënë bazuar në Rregulloren e Keshillit të Ministrave e të masave të këtij urdhëri mund të zgjatet pas datës së hyrjes në fuqi të ndonjë amendamenti, ose të adoptimit të këtyre masave, në rastet kur një miratim i tillë i tipit nuk është dhënë në bazë të masave të reja.

Neni 22

Kur miratimi i tipit nuk është zgjatur, ky miratim asnjehere nuk mund të vazhdojë të aplikohet në instrumentet matese tashme në shërbim.

Fiksimi i shenjave të miratimit të tipit në instrumentet matese të prodhuara në përputhje me tipin e miratuar

Neni 23

Shenja për miratimin e tipit do të jetë sipas Aneksit 3 të përfshirë në këtë urdher

Neni 24

Shenja për përjashtimin nga miratimi i tipit do të jetë sipas Aneksit.4, përfshirë në këtë urdher

Neni 25

Shenja e miratimit të tipit me efekt të kufizuar do të jetë (Aneksi 5) përfshirë në këtë urdher.

Neni 26

Shenjat sipas neneve 23, 24 dhe 25 duhet të fiksohen në çdo instrument mates dhe / ose në certifikatën e miratimit të tipit.

Neni 27

Kur miratimi i tipit nuk kërkohej për një kategori të instrumenteve që kënaqin kërkesat e Rregullores së Keshillit të Ministrave, prodhuesi mundet me përgjegjësinë e tij të fiksojë tek instrumentet matëse të kësaj kategorie shenjen speciale (Aneksi 5) përfshirë në këtë urdher.

Neni 28

Shenjat e përmendura në nenet 23,24 e 25 të fiksuar nga prodhuesi në përputhje me masat e këtij urdhëri duhet të jenë në një vend të dukshëm të instrumentit dhe të gjithë paisjeve ndihmëse që i nënshtrohen verifikimit dhe duhet të jenë të lexueshme dhe të përfshirë.

Modifikimet ose shtesat në tipin e miratuar

Neni 29

Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij do të informojë Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë rreth ndonjë modifikimi apo shtese në tipin e miratuar

Neni 30

Modifikimet ose shtesat e një tipi të miratuar duhet të marrin një miratim shtesë të tipit nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, atëherë kur këto ndryshime influencojnë ose mund të influencojnë rezultatet e matjeve ose kushtet e përkruara për përdorim të instrumenteve matëse .

Neni 31

Në rastin e modifikimit, duhet të jepet një miratim i ri në vend të një shtese në certifikatën origjinale të miratimit të tipit, nëse ky është modifikuar pas amendimit apo adaptimit të masave të këtij urdhëri apo të Rregullores së Keshillit të Ministrave, në një mënyrë të tillë që tipi i modifikuar duhet të miratohet sipas masave të reja.

Neni 32

Procedura për miratimin e modifikimeve ose shtesave të një tipi është e njëjta me procedurën e miratimit të tipit

Neni 33

Metrologu i autorizuar që kryen verifikime të instrumenteve matëse do të informojë inspektorin e drejtorisë së Inspektimit Metrologjik brenda Drejtorisë të Përgjithshme të Metrologjisë për rastet e:

1. tipit që nuk është miratuar dhe për kategorinë që nuk është përjashtuar nga miratimi i tipit
2. tipit që është modifikuar ose shtuar dhe ndryshimet që influencojnë rezultatin e matjeve ose kushtet e përkruara për përdorim të instrumentit, por modifikimet ose shtesat nuk janë miratuar.

Miratimi i tipit ne rastin e perdorimit te teknikave te reja

Neni 34

Kur jane perdorur teknika te reja jo te parashikuara ne Rregulloren e Keshillit te Ministrave, mund te jepet miratim tipi me efekt te kufizuar dhe te perfshije kufizimet e meposhteme:

1. limit ne numerin e instrumenteve qe mund te mbulohen nga miratimi i tipit
2. detyrim per te njoftuat autoritetin kompetent per vendin e instalimit
3. kufizim ne perdorim
4. kufizime speciale lidhur me tekniken e perdorur

Neni 35

Kur jepet miratim tipi me efekt te kufizuar, çertifikata e miratimit te tipit do te paraqese qarte kufizimet, detyrimet dhe masat kufizuese te imponuara

Neni 36

Miratimi i tipit me perdorim te teknikave te reja nuk mund te jepet ne se:

1. nuk ka hyre ne fuqi nje Rregullore e Keshillit te Ministrave per kete kategori instrumentesh matese
2. ka devijime nga kerkesat tekniko-metrologjike te dhena ne rregulloren e Keshillit te Ministrave ose ne miratimin e tipit

Neni 37

Periudha e vlefshmerise se nje miratimi te tille te tipit nuk do te kaloje dy vjet. Ajo mund te shtrihet deri ne tre vjet te tjera me e shumta.

Depozitimi i mostres se instrumentit

Neni 38

Ne rastet e permendura ne Rregulloren e Keshillit te Ministrave, ose ne se e konsideron te domosdoshme, Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise kerkon depozitimin e mostres se instrumentit per te cilen eshte dhene miratimi i tipit

Neni 39

Ne vend te depozitimit te mostres te instrument mates Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise mund te autorizojte depozitimin e pjeseve te instrumentit, te maketit apo vizatimeve dhe kjo do te permendet ne çertifikaten e miratimit te tipit.

Refuzimi i miratimit te tipit

Neni 40

Ne se eshte percaktuar per nje instrument mates qe tipi i testuar nuk ploteson karakteristikat teknike dhe metrologjike te pershkruara ne Rregulloren e Keshillit te Ministrave, Drejtori i

Drejtorise te Metrologjise nxjerr nje vendim per refuzimin e miratimit te tipit te instrumentit mates perkates

Njohja e miratimit te tipit te instrumenteve matese qe importohen ne Shqiperi

Neni 41

1. Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise do te njohje miratimin e tipeve te instrumenteve matese qe importohen ne Shqiperi. Per kete qellim do te pranohen:

- a. certifikatat, raportet inspektimit dhe rezultatet e testimeve te kryera per instrumentat mates me qellim miratimin e tipit ne se ato jane lëshuar /ose bere ne nje vend antar te EU ose EEA, ose qe ka nenshkruar nje marreveshje me EU dhe ne se keto certifikata, raporte dhe rezultate testimi i jane paraqitur Drejtorise se Pergjithshme te Metrologjise . Mostra te instrumentave mates dhe testime teknike per to nuk kerkohen
- b. raportet e testimit te instrumentave matese , nëse ato janë lëshuar sipas kërkesave të Organizatës Ndërkombëtare të Metrologjisë Ligjore dhe i jane paraqitur Drejtorise se Pergjithshme te Metrologjise . Ne kete rast mund te kerkohen mostra te instrumentit mates dhe testime teknike per to.

3.Kerkesa per njohje miratim tipi mund te behet vetem nga prodhuesi , perfaqesuesi i tij i vendosur ne Shqiperi dhe nga importuesi qe ne kete rast merr pergjegjesite e prodhuesit

4.Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise do te ekzaminoje plotesimin e kushteve te mesiperme dhe do te nxjerrre nje vendim per njohjen e miratimit te tipit bazuar ne ekzaminimin e dokumentacionit te paraqitur dhe ne raste te vecanta edhe ne testimet e kryera. Shenja e njohjes se miratimit te tipit jepet ne Aneksin 6.

5. Drejtori i Pergjithshem i Drejtorise se Pergjithshme te Metrologjise do te percaktoje rregullat e aplikimit ,te shqyrtimit te aplikimit dhe te dhenies dhe terheqjes se njohjes se miratimit te tipit dhe verifikimit fillestar si dhe formatet e dokumentacionit te nevojshem

Shenja e miratimit te tipit qe perjashton verifikimin fillestar

Neni 42

Shenja e miratimit te tipit qe perjashton verifikimin fillestar jepet per ate kategori instrumentesh matese qe percaktohen ne Rregulloren e Keshillit te Ministrave Aneksi 7

Regjistrimi i tipit te miratuar

Neni 43

Te gjitha certifikatat e miratimit te tipit , njohjes se miratimit te tipit , si dhe ato te miratimit te tipit me kufizime , miratimit te tipit te modifikimeve apo shtesave do te regjistrohen ne regjistrin e permendur ne nenin 4 .

Formati i kerkeses per miratim tipi

APLIKIM PER MIRATIM TIPI

DREJTORISE TE PERGJITSHMETE METROLOGJISE

1. Te dhena te pergjithshme te aplikantit

Emri i Subjektit prodhues apo perfaqsesit te tij ne Shqiperi

.....

Adresa e subjektit aplikues

.....

Nr.regjistrimit te subjektit

.....

Personi i kontaktit

Nr.Tel.....

Nr.Fax.....

E-mail.....

2. Tipi i instrumentit mates per vleresim/miratim (*)

(*) shenim pjesa Nr.2 e kerkeses varion nga tipi dhe fusha e matjeve qe i perket tipi i instrumentit mates i cili do te vleresohet



Drejtoria Pergjithshme e Metrologjise

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise

Rruga "Sami Frasheri" No.33, Tirana, Tel&Fax: +355 42282 44 E-mail: metrology@dpmk.gov.al

ÇERTIFIKATE
E MIRATIMIT TE TIPIT TE INSTRUMENTIT MATES
(.....)

Numuri i çertifikates

.....

Perudha e vlefshmerise

.....

Prodhuesi

.....

Pershkrimi i instrumentit mates

.....

.....

.....

.....

.....

Lloji i miratimit te tipit

Shenja e miratimit te tipit

Data e dhenies te çertifikates

DREJTORI PERGJITHSHEM

Emri mbiemri, firma vula

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjise

Rruga "Sami Frasheri" No.33, Tirana,

Tel&Fax: +355 42282 44


E-mail: metrology@dpmk.gov.al

Aneksi 3

Shenja e miratimit te tipit .

Ne pjesen e sipërme te S vendoset kodi i vendit dhe dy shifrat e fundit te vitit

Ne pjesen e poshtme te S vendoset numuri identifikues i miratimit te tipit (Nr.ne regjister)



Permasat jepen ne pjese te njesise e cila konsiderohet te jete nje nga permasat e dhena ne serine
qe vijon: 12,5 mm , 6.3 mm dhe 3.2 mm

Lartesia e gernes S merret	1 njesi
Gjeresia e gernes S	0.9
Trashesia e gernes S	0.08
Rezja e madhe e jashteme	1
Rezja e vogel e jashteme	0.248
Rezet e brendeshme	meren sa rezet e jashteme minus trashesine e gernes

Permasat e germave A dhe L merren :

- gjersia 0.14
- lartesia 0.20
- trashesia 0.022

Permasat e numrave merren:

- Gjeresia 0.10
- Lartesia 0.20
- Trashesia 0.020
- Rezet e brendeshme te vogla 0.03
- Rezet e brendeshme te medha 0.06
- Rezet e jashteme merren sa rezet e brendeshme plus trashesine e numurit

Aneksi 4

Shenja e perjashtimit nga miratimi i tipit



Permasat kryesore jepen ne pjese te njesise e cila konsiderohet te jete nje nga permasat e dhena ne serine qe vijon: 12,5 mm , 6.3 mm dhe 3.2 mm

- Lartesia e shenjes merret 1 njesi
- Gjeresia e shenjes merret 0.9
- Trashesia e vijave 0.14
- Trashesia e vijave te holla 0.08
- Rezet e rumbullakimit 0.14

Aneksi 5

Shenja e miratimit te tipit te kufizuar

L S
AL 00
000

Permasat e germes L jepen ne pjese te njesise e cila konsiderohet te jete nje nga permasat e dhena ne serine qe vijon: 12,5 mm , 6.3 mm dhe 3.2 mm

Lartesia e germes L merret	1 njesi
Gjeresia e germes L	0.75

Aneksi 6

Shenja e njohjes se miratimit te tipit


N S
AL 00
000

Permasat e germes N jepen ne pjese te njesise e cila konsiderohet te jete nje nga permasat e dhena ne serine qe vijon: 12,5 mm , 6.3 mm dhe 3.2 mm

Lartesia e germes N merret	1 njesi
Gjeresia e germes N	0.75

Aneksi 7

Shenja e miratimit te tipit qe perjashton verifikimin fillestar



Permasat e gjashtekendeshit meren

- Lartesia sa dyfishi i lartesisë së gërmes S (aneksi 1.3)
- Trashësia e vijës së konturit 0.08 njësi